



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.387 Prot.

Tiranë, më 27.02. 2025

V E N D I M

Nr. 40, Datë 27.02. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 262 Regj., datë 24.12.2024, paraqitur nga znj. A.K , kundër Fondacionit “Albanian American Development Foundation”, Dega në Shqipëri,³ në të cilën pretendon diskriminim në kuadër të termit “për çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese ndër të tjera ka parashtruar:

Në faqen zyrtare të AADF, jam njohur me datat e mundësisë për të aplikuar në programin MIP (The Master’s and Internship Program), program i kësaj organizate, i cili zotëron programin e bursave për diplomë master që synon t’i ofrojë profesionistëve të rinj të cilët janë banorë të përhershëm dhe shtetas shqiptar, mundësinë për të marrë një diplomë master nga një institucion akademik i miratuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas përfundimit të studimeve dy vjeçare në SHBA, anëtarët e MIP kërkohen të kthehen në Shqipëri pas studimeve dhe të aplikojnë aftësitë e tyre për përmirësimin e Shqipërisë. Duke e dashur me të vërtetë shumë këtë program prej vitesh, unë më datën 31 mars 2023 kam dërguar aplikimin fillestar së bashku me dokumentacionin

¹ Në vijim referuar me akronimin LMD

² Në vijim referuar si Komisioneri.

³ Në vijim referuar me akronimin AADF.

mbështetës që nevojitej. Në vijim të aplikimit, më datën 17.07.2023, unë marr përgjigje pozitive që kam kaluar fazën e parë dhe ju dërgoj në vijim rezultatet e provimit TOEFL.

Rezultatet e mia në provimin TOEFL ishin 104 pikë, aplikantët e tjerë kishin pikë më të ulëta. Konkretisht, aplikuesja Y.S , fituese e programit mori 102 pikë.

Pas kalimit të fazës së parë, ne duhet që të bënim një provim ekstra, provim të cilin e bënte grupi qëdëshironte të aplikonte në shkollat e biznesit/ekonomisë. Provimi që unë duhet të bëja quhej GMAT (Graduate Management Admission Test). Nga të gjithë studentët e tjerë unë dhe një aplikant tjetër, konkretisht I.D morëm pikët më të larta, nga 510 pikë secili nga ne. Konkurentët e tjerë morën shumë pikë më pak. Y.S (fituese e programit MIP 390 pikë), J.Q (fituese e programit MIP 460 pikë).

Në datën 2 nëntor 2023, njëri prej koordinatorëve të American Council, V.B na nis një *e-mail* zyrtar që për shkak të ankesave të shumta nga ana e pjesëmarrësve në provimin GMAT, na kishte dhënë të drejtën për të ridhënë provimin e GMAT. Data e re e provimit ishte data 24 nëntor 2023, gati një muaj më pas datës fillestare 30 tetor 2023. Nga studentët provimin e ripërsëriti vetëm Y.S, e cila përsëri mori më pak pikë se unë, konkretisht këtë herë 470 pikë.

Dua të përmend që në të gjitha vitet e implementimit të këtij programi, kjo është hera e parë që një mundësi e tillë i jepet aplikuesve. Ndërkohë që nga ana e z. B përmendet shprehimisht se ankesat nga ana e aplikuesve kanë qenë të shumta, në fakt rezulton që provimin pas një muaji e ripërsëriti vetëm shtetasja Y.S.

Pas kësaj faze, mora njoftim më datë 30 nëntor 2023 që isha përzgjedhur për fazën finale dhe në datën 13 dhjetor 2023, ora 15:00 kisha intervistën me stafin e AADF. Gjatë ditës së intervistës qasja e panelit ndaj meje ka qenë shpërfillëse. Si fillim në momentin që po hyja në dhomën ku po bëheshin prezantimet, unë dëgjova që njëri nga anëtarët e komisionit në momentin që po hyja u shpreh duke thënë: “Erdhi kjo e komunitetit”. Besoj duke ju referuar faktit që unë kam punuar pranë Qendrës Streha LGBT si ekonomiste. Në parantezën e takimit mu shpreh qartë nga ana e njërit prej anëtarëve të panelit, konkretisht z.V.B që duhet të isha krenare që kisha arritur në këtë fazë edhe pse mund të mos e fitoja në vijim. Ironitë vijuan edhe nga ana e anëtarëve të tjerë të panelit, z. M.M , i cili u shpreh se duke qenë se isha intervista e fundit për atë ditë gjasat që unë të qaj pas këtij takimi ishin të larta. Gjatë vijimit të intervistës, individë të panelit vlerësues rrinin në telefon dhe gjatë fundit të intervistës njëri nga anëtarët e apelit, z. A. S , vendosi të largohej nga intervista.

Në datën 18 dhjetor 2023 marr njoftimin që nuk jam shpallur fituese e programit pa asnjë shpjegim nga ana e AADF.

Në datën 3 maj 2024 në faqen e *Instagramit* shoh që njëri nga kandidatët e mëparshëm të refuzuar nga AADF MIP program, konkretisht K.C ishte shpallur fitues. Të gjitha mesazhet dhe komunikimet e mia me K.C tregojnë shumë qartë që ai në fillim u skualifikua nga programi, madje

ishte shumë i indinjuar sa i takon skualifikimit të tij dhe madje shprehet në komunikim me mua që “nuk do hiqte dorë”, dhe më pas u shpall fitues.

Mendimi pas kësaj çfarë ndodhi më çon tek fakti se zgjedhja e fituesve të programit të AADF ka qenë një zgjedhje e njëanshme pasi individët e përzgjedhur kanë pasur lidhje me palë të treta ndaj të cilave AADF si OJF ka pasur përfitime të tjera. K.C drejton OJF United Nations Association Albania, organizatë e cila është e lidhur politikisht me United Nation dhe përfiton financim të vazhdueshëm nga ta. Pa dashur të jem paragjyquese, por gjithashtu njëri nga fituesit e tjerë të programit MIP është i lidhur politikisht me Partinë Demokratike, gjë që më bën të mendoj që fakti që unë nuk jam përzgjedhur pavarësisht rezultateve e bën zgjedhjen e fituesve të njëanshme në bazë të interesave të palëve.

Ndryshe nga aplikantët e tjerë unë këtë program do ta përdorja për t'i sjellë Shqipërisë një treg ekonomie dinamik, duke ndërtuar strukturat e para të bursës shqiptare. Zhvillimi i bursës shqiptare do të simbolizonte hapat e para të ekonomisë shqiptare drejt globalizimit. Aplikantët e tjerë do ta përdornin këtë mundësi për të zhvilluar interesat e tyre personale kundrejt zhvillimit të interesave të përgjithshme kolektive, informacion ky i cili më është dhënë nga vetë aplikantët e tjerë.

AADF-së i jam drejtuar edhe me një *e-mail* zyrtar në datën 07 maj 2024, ku i kërkoja që të më jepte më shumë informacion në lidhje me praktikën e tyre të përzgjedhjes. Deri më sot nuk kam marrë asnjë përgjigje. AADF vendosi që të më injorojë totalisht. Tërësia e menaxhimit të këtij programi ishte zhgënjyjes. Gati një vit e gjysmë i hedhur në plehra, mundësi të tjera të humbura nga angazhimi me AADF, dhe unë sot kërkoj diçka që me meritokraci, duke u bazuar në sistemin e pikëve, duhet të më ishte dhënë.

Për rreth 5 vite kam punuar me subjekte private dhe me shoqërinë civile. Përmes punës time, kontributi im është njohur vazhdimisht duke marrë gjithashtu edhe medalje ari nga CNDCH, institucion i shtetit francez për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nuk e kisha menduar asnjëherë që i gjithë kontributi ndaj shoqërisë shqiptare do të më rikthente në këtë pikë. Nuk e kisha menduar që do të paragjykoheja në këtë formë, për shkak të *peer pressure*, për shkak të bindjeve politike të personave të tjerë, si dhe për shkak të aktivizimit të punës time me komunitetin LGBT. Nuk do ta bëja kurrë këtë kërkesë nëse nuk do kisha dalë e para me pikët në grupin tim. Gjendja në një situatë të tillë më shtyn të mendoj që në këtë situatë jam paragjykuar.

Mund të vërtetohet lehtësisht që në të gjitha vitet në të cilat është zhvilluar ky program, asnjëherë nuk ka pasur një praktikë të tillë për ripërsëritjen e provimit. Pavarësisht se kjo praktikë është ofruar për të gjithë grupin, kjo mundësi nuk është e drejtë pasi ka një datë në të cilën është përcaktuar dita e provimit dhe jo për shkak se një nga aplikueset ka kërkuar ripërsëritjen e provimit të cenohen të gjithë personat e tjerë të cilët kanë pasur rezultate shumë të kënaqshme dhe kanë investuar në kohë që të kenë ato rezultate përfundimtare. Për më tepër që të jepet mundësia që provimi të bëhet pas një muaji. Logjika të çon tek fakti që nëse ka pasur një problem teknik, provimi duhet të bëhet disa ditë më vonë dhe jo një muaj më pas, sepse ky në të kundërt është një muaj më shumë kohë për t'u përgatitur si dhe për ne të tjerët ulet shansi të marrim përsëri të njëjtat

pikë, për shkak të impenjimeve të tjera në punë, familjare, personale etj, ne nuk kishim mundësinë që t'i përkushtoheshim edhe një muaj tjetër këtij programi. Kjo më bën të ndjehem që, pavarësisht faktit se mundësia ka qenë për të gjithë e njëjtë, sa i takon ripërsëritjes së provimit, në dukje një trajtim i barabartë, por në fakt është një trajtim i pabarabartë pasi një person i vetëm është trajtuar më me përparësi se gjithë të tjerët, të cilët kanë qenë të kënaqur me rezultatet e provimit dhe kanë qenë duke pritur fazën e radhës. Është pikërisht aplikuesja Y.S , e cila e ripërsërit provimin dhe kualifikohet në program. Kjo më jep të gjithë të drejtën që të dyshoj që zgjedhja e aplikuesve nuk është bërë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë por se personave të ndryshëm i është dhënë mundësi pikërisht me qëllim kualifikimin në program.

Gjatë parashtrimeve të mia si ankuese në këtë proces pretendoj diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”, duke argumentuar se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm ndaj meje ka ardhur si shkak i anshmërisë së komisionit dhe programit në përzgjedhjen përfundimtare të aplikuesve. Kjo tregohet që nga fakti që unë para se të futem në sallë për prezantimin e temës u përcaktova si “*kjo e komunitetit*” nga ana e njërit prej anëtarëve të komisionit, nga mungesa e vëmendjes për shkak se gjatë prezantimit të temës time për të cilën isha munduar aq shumë dhe përgatitur me shumë dashuri, anëtarë të komisionit mbanin telefonin në dorë duke treguar shpërfillje ndaj prezantimit tim, si dhe për faktin që para se të filloja prezantimin mu tha prapë nga ky komision që gjasat që unë të qaja duke qenë se isha prezantimi i fundit janë të larta. Shpërfillja e AADF-së ndaj meje ka vazhduar edhe në momentin që unë kam kërkuar një shpjegim sa i takon transparencës së zgjedhjes së aplikuesve, për të cilin nuk kam marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Ngre këtë pretendim duke qenë se Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Konkretisht neni 1, i ligjit liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë të listuara në nenin 1.

Konkretisht, ajo çfarë më bën të dallueshëm nga komisionerët dhe nga vetë programi, është pikërisht pozita ime si aplikuese, krahasimisht me ato të cilët janë përzgjedhësit e aplikuesve. Gjithashtu, mua më diferencon me dis persona të tjerë të cilët kanë aplikuar dhe fituar, fakti që nuk jam e mbështetur nga asnjë përveçse tek mendi im për të arritur sa më lart.

Shkak për diskriminimin tim është bërë pozita ime si aplikuese, mos pasja lidhje dhe interesa të tjerë me AADF. Unë nuk jam respektuar në momentin e aplikimit e as në vazhdimësi. Unë nuk jam përzgjedhur dhe pavarësisht se kam kërkuar për arsye dhe transparencë nuk kam marrë asnjë përgjigje sa i takon kësaj, njësoj sikurse pavarësisht faktit që kam pasur më shumë pikë se aplikuesit e tjerë dhe madje njëri prej fituesve ka ripërsëritur provimin pas një muaji, dhe tjetri është skualifikuar për t'u kualifikuar më vonë. Për këtë arsye mendoj që ky diskriminim duhet konsideruar si “*çdo shkak tjetër*”. Kjo do të rezultojë e provuar, bazuar në kontekst të dokumentimit në kuadër të “*shkakut*” që nuk jam pranuar dhe trajtuar në atë mënyrë.

Pala ankuese kërkon përfundimisht nga Komisioneri shqyrtimin e ankesës, hetimin e mënyrës së përzgjedhjes së aplikuesve fitues të këtij programi, dhe konstatimin e diskriminim të ankueses nga ana e AADF.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 89 prot, datë 13.01.2025, Komisioneri, kërkoi informacion dhe dokumentacion shkresor nga ana e AADF në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, përsa i takon pretendimeve të paraqitura nga pala ankuese.
2. Me shkresën me nr. 25/007 prot, datë 24.01.2024⁴, AADF, ka depozituar prapësimet në lidhje me ankesë. Nëpërmjet kësaj shkrese, ndër të tjera AADF kërkon konstatimin nga Komisioneri të mungesës së juridiksionit administrativ dhe kompetencës së Komisionerit mbi AADF, duke parashtruar:

AADF është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar më 9 shtator 2009, sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, SH.B.A., me seli në New York, SH.B.A., e cila vepron në Shqipëri nëpërmjet degës së saj, Albanian- American Development Foundation – Dega Shqipëri, dhe financohet me fonde të Qeverisë së SH.B.A. AADF organizohet, funksionon dhe menaxhon fondet e veta në bazë të statutit, aktit të themelimit dhe marrëveshjes së grantit, të cilat përcaktojnë fushën e veprimtarisë së saj brenda kuadrit ligjor të ndihmës së huaj të SH.B.A, mënyrën e përdorimit të fondeve dhe raportimin e vazhdueshëm pranë USAID si përfaqësues i Qeverisë së SH.B.A.

AADF është një organizatë e cila vepron në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, është një organizatë e mirë organizuar nga pikëpamja strukturore korporative dhe e qeverisjes korporative, me procedura formale të qarta dhe transparente, që sigurojnë efektivitet dhe efikasitet të investimeve të kryera me financimin e AADF, në bashkëpunim të plotë me të gjitha palët përkatëse të përfshira në zbatimin e projekteve të ndryshme. Vendimet për projektet e AADF-së merren nga Bordi Drejtues i saj, i cili ka në anëtarësi personalitete nga Fondi – Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, anëtarësi që siguron vendimmarrje të besueshme bazuar në ligj dhe në aktet e brendshme të AADF.

AADF ka ideuar, zotëron dhe po implementon që prej vitit 2016, në bashkëpunim me *American Councils for International Education*, Programin “*AADF MIP Master’s Degree Fellowship*”, një program i cili synon t’u ofrojë profesionistëve të rinj shqiptarë dhe me vendbanim të përhershëm në Shqipëri, mundësinë për të përfituar një diplomë masteri nga një institucion akademik i miratuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

American Councils for International Education është një organizatë jofitimprurëse ndërkombëtare e themeluar në 1974, me seli kryesore në Washington D.C, e cila ka një eksperiencë të gjatë në administrimin e programeve ndërkombëtare të edukimit përmes mbështetjes individuale të

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.89/1 prot datë 27.01.2025.

vazhdueshme të studentëve të huaj që studiojnë në Sh.B.A⁵. *American Councils* ka rënë dakort të bashkëpunojë me AADF për ofrimin e shërbimeve të administrimit të Programit MIP, përfshirë programin e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në këtë Program.

AADF është subjekt përfitues i Marrëveshjes Ekonomike Dypalëshe, të lidhur midis Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 10.06.1992 dhe, bazuar në këtë Marrëveshje Dypalëshe, AADF ka imunitet ndaj çdo përgjegjësie civile në Republikën e Shqipërisë (neni 3 pika (d) e Marrëveshjes Bilaterale) dhe është e përjashtuar nga juridiksioni shqiptar.

Ky status i AADF-së është konfirmuar edhe nga tre vendime të Gjykatave Shqiptare, të cilat kanë shpallur mos juridiksionin për kërkimin drejtuar AADF (Vendimi nr.1373/493, datë 12.05.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Vendimi nr.1685, datë 29.12.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Vendimi nr.00-2021-998, datë 28.06.2021, të Gjykatës së Lartë, *bashkëlidhur në cilësinë e provës*).

Sikurse ka arsyetuar edhe Komisioneri në një rast tjetër ankimi kundër një institucioni që gëzon privilegjet dhe imunitetet e dhëna nga Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, *“Gjykatat janë institucionet pranë të cilave mund të kundërshtohen aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, ndër të cilat edhe vendimarrja e KMD-së. Po ashtu, neni 31/1 i Konventës së Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”, ka përcaktuar qartë gëzimin e imunitetit të agjentit diplomatik edhe përsa i takon juridiksionit administrativ.” (Vendim nr.130, datë 12.07.2021 i Komisionerit).*

Marrëveshja Bilaterale parashikon në pikën “f” të nenit 3 të saj se : *“f) Asnjë në këtë marrëveshje nuk ka për qëllim të prekë privilegjet dhe imunitetet e dhëna nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike”*. Rrjedhimisht, në kontekst të legjitimitetit të ankimit kundërt subjektit ndaj të cilit ankuesja ka pretenduar diskriminimin, AADF përfshihet tek subjektet që gëzojnë imunitet kundërt proceseve administrative që mund të ndërmerren ndaj tyre nga vendi pritës. Në këtë kuadër, nuk mund t’i nënshtrohet hetimit administrativ pranë Komisionerit.

Bazuar në sa më sipër, AADF kërkon konstatimin nga Komisioneri të mungesës së juridiksionit administrativ dhe kompetencës së Komisionerit mbi AADF, për sa kohë edhe vetë gjykata ka pranuar mungesën e juridiksionit gjyqësor lidhur me shqyrtimin e çështjeve me palë AADF në territorin e Shqipërisë.

3. Pala ankuese depozitoi kundërshtimet e saj ndaj qëndrimit të AADF, të cilat u administruan pranë Komisionerit me nr.89/2 prot., datë 10.02.2025. Në lidhje me kërkimin e AADF për

⁵ <https://www.americancouncils.org/>

shpalljen e mungesës së juridiksionit dhe kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e ankesës, pala ankuese parashtroi kundërshtimet si më poshtë:

AADF pretendon se është subjekt përfitues i Marrëveshjes Ekonomike Dypalëshe ndërmjet SHBA dhe Shqipërisë, duke argumentuar se gëzon imunitet ndaj çdo përgjegjësie civile dhe se nuk është subjekt i juridiksionit shqiptar edhe pse AADF në parashtimet e saj shprehet se ky fondacion vepron në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar.

Sidoqoftë, përdorimi i Marrëveshjes Dypalëshe si mburojë ndaj ankesave administrative është një interpretim i tepruar dhe jashtë kontekstit të saj. Marrëveshja synon të mbrojë AADF nuk mund të përdoret për t'ju shmangur mbikëqyrjes administrative, veçanërisht në lidhje me çështje që lidhen me diskriminimin dhe trajtimin e padrejtë të aplikantëve. Komisioneri ka juridiksion mbi çdo subjekt që operon në Shqipëri, përfshirë AADF, pasi është një organizatë që vepron në këtë territor dhe ndërmerr procese përzgjedhjeje të cilat prekin individë shqiptarë. Asnjë marrëveshje nuk mund të ndalojë institucionet shqiptare të hetojnë pretendime për diskriminim brenda territorit të Shqipërisë.

Vendimet e mëparshme të Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, të cilave i referohet AADF, nuk kanë të bëjnë me mundësinë dhe të drejtën për të ankimuar një vendimarrje që prek të drejtat e qytetarëve shqiptarë.

Vetë AADF në parashtimet e saj përmend se: Programi MIP bazohet në parimet e gjithëpërfshirjes dhe nuk diskriminon në asnjë rast për shkaqe etnie, moshe, ngjyre, gjinie, besimi fetar etj. Atëherë pyetja që shtrohet për AADF është: Në rast se ky parim nuk respektohet, cili është institucioni që sipas kësaj marrëveshje shtetasit që pretendojnë të jenë diskriminuar mund t'i drejtohen?

III. Vlerësimi i Komisionerit.

Rezulton se, ankuesja A.K ka aplikuar në Programin MIP më datë 31.03.2023, ka kaluar me sukses disa faza të procesit të konkurrimit, por është skualifikuar duke mos u shpallur fituese në fazën e intervistës. Pas intervistës (të zhvilluar më datë 13.12.2023) ankuesja është njoftuar më datë 18.12.2023 (nëpërmjet *e-mailit*) se nuk ishte përzgjedhur si fituese e Programit MIP.

Programi MIP, është një program që zbatohet nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, AADF, dhe synon t'u ofrojë profesionistëve të rinj shqiptarë dhe me vendbanim të përhershëm në Shqipëri, mundësinë për të përfituar një diplomë masteri nga një institucion akademik i miratuar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ankuesja A.K ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi në të cilën pretendon se është diskriminuar nga ana e AADF, gjatë procesit të përzgjedhjes në kuadër të Programit "*MIP Master's Degree Fellowship*".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një institucion i pavarur, i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar (LMD).

Në bazë të nenit 32, pika 1, germa “a” të LMD, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Neni 4, i LMD, përcakton rrethin e subjekteve të cilët gëzojnë mbrojtje nga ky ligj. Në pikën 1, të nenit 4, të LMD shprehimisht përcaktohet: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.”*

Neni 7, i LMD, përcakton rrethin e subjekteve të cilët mbartin detyrime sipas ligjit dhe që mbajnë përgjegjësi në rast të shkeljes të së drejtës për të mos u diskriminuar, pra shkelin ndalimin e e diskriminimit sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në pikën 1, të nenit 7, të LMD shprehimisht përcaktohet se: *“ 1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Sa më sipër, ankuesja gëzon legjitimitet për t’ju drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi, pasi ajo përfshihet në rrethin e subjekteve të cilët gëzojnë mbrojtje sipas LMD dhe provon se ka një interes legjitim në paraqitjen e ankesës, interes i cili sipas ankuses është cenuar nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën, AADF duke e skualifikuar atë dhe duke mos e shpallur fituese të Programit MIP.

Nga ana tjetër, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Dega në Shqipëri e Fondacionit “Albanian American Development Foundation”, person juridik në formën e një organizate jo fitimprurëse, i cili është krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 359, datë 18.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet zbatimit të Programit MIP dhe vendimmarrjes së tij për të mos shpallur fituese ankuesen, përfshihet në rrethin e subjekteve të parashikuar nga neni 7, i LMD, dhe nga pikëpamja e legjitimitetit pasiv, AADF legjitimohet si subjekt ndaj të cilit mund të paraqitet ankesa objekt shqyrtimi.

Megjithatë, legjitimimi i palëve në një procedurë administrative, nuk është parakushti i vetëm që duhet të përmbushet për të vijuar me procedurën administrative të shqyrtimit të ankesës. Juridiksioni është një nga parakushtet parësore dhe thelbësore, mungesa e të cilit sjell si pasojë pamundësinë e shqyrtimit në themel të pretendimeve të palës ankuese, nga ana e Komisionerit.

Komisioneri, çmoi të domosdoshme se, përpara vlerësimit të bazueshmërisë në prova dhe në ligj të pretendimeve të palës ankuese dhe prapësimeve të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, të marrë në shqyrtim kërkimin e paraqitur për shpalljen e mungesës së juridiksionit të Komisionerit ndaj AADF në shqyrtimin e ankesës objekt shqyrtimi, pasi mungesa e juridiksionit

pamundëson vazhdimin e mëtejshëm të shqyrtimit administrativ të ankesës nga ana e Komisionerit. Kjo pasi koncepti i juridiksionit lidhet drejtpërdrejtë me konceptin e procesit të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese në vendim nr.11, datë 23.04.2009 është shprehur se : “*Bazuar në standardin e GJEDNJ (Çështja Jorgic v. Germany), Gjykata çmon gjithashtu se shprehja “gjykatë e krijuar me ligj”, si element i procesit të rregullt ligjor i parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane, reflekton parimin e shtetit të së drejtës të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit...*”.

Sipas qëndrimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nëse një **gjykatë** nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të gjykuar kërkesën në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është “*e krijuar me ligj*”, sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut⁶.

Referuar Kodit të Procedurave Administrative (neni 22, pika 1), përcaktohet se: “*Fusha e ushtrimit të veprimtarisë dhe tërësia e kompetencave të organeve publike, të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, përbën juridiksionin administrativ.*”

Me termin “*Juridiksion*” kuptojmë, rrethin e çështjeve, që në bazë të ligjit, organet e një sistemi kanë të drejtë të zgjidhin, ose e drejta e organeve të shtetit për të zgjidhur çështjet që përfshihen në funksionet e tyre duke zbatuar në çdo rast ligjin. “*Juridiksioni është një nga funksionet e shtetit. Ai bën dallimin ndërmjet pushteteve të ndara e te pavarura ndërmjet tyre, në funksionet ndërmjet organeve shtetërore dhe ndërmjet tyre e organeve te pushtetit gjyqësor*”. Për këtë arsye ne njohim dhe disa lloje juridiksioni, gjyqësor (civil apo penal), administrativ, etj. Në bazë të legjislacionit shqiptar ekzistojnë dy ndarje të mëdha të juridiksionit, atij administrativ dhe gjyqësor. **Juridiksioni administrativ sipas ligjit shqiptar, përfshin të gjithë rrethin e atyre çështjeve të cilat i janë lënë për zgjidhje organeve shtetërore, të ndryshme nga gjykatat**, ndërsa **juridiksioni gjyqësor** përfshin rrethin e çështjeve që në bazë të ligjit u janë ngarkuar për zgjidhje **gjykatave shqiptare**⁷.

Komisioneri, si një organ publik e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se:

“*Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: “a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të*

⁶ Vendim Nr. 00-2015-2907 i Vendimit (336), datë 01.07.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁷ Vendim Nr. 00-2015-2907 i Vendimit (336), datë 01.07.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

Neni 122 i Kushtetutës përcakton se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë. 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”, e cila ka hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998. Neni 31 i Konventës ka përcaktuar se:

“1. Agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit penal të Shtetit pritës. Ai gëzon gjithashtu imunitetin e juridiksionit të tij civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë: a) për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e Shtetit pritës, përveç kur agjenti diplomatik e posedon atë për llogari të Shtetit akreditues për qëllimet e misionit. b) për një veprim lidhur me një trashëgimi në të cilin agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ose legatar, si privat dhe jo në emër të Shtetit akreditues. c) për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdo qoftë, të ushtruar nga agjenti diplomatik në Shtetin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare. 2. Agjenti diplomatik nuk është i detyruar të japë dëshminë e tij. 3. Asnjë masë zbatimi nuk mund të merret karshi agjentit diplomatik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat a), b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni, dhe me kusht që zbatimi të kryhet pa cenuar paprekshmërinë e personit të tij ose të banesës së tij”.

Neni 39 i K.Pr.Civile përcakton se: “Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur: a. pranojnë vullnetarisht; b. Ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike”.

Aktet ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998), Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963), Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjet dy palëshe të ndryshme të lidhura me shtetet Shqiptar dhe shteteve të tjera, përcaktojnë rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërtimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë. Përjashtimi nga

juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm

Marrëveshjet ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), kanë një status superior ndaj ligjeve. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë mungesën e juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe.

Në nenin 3, germa “d”, të Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, shprehimisht parashikohet: *“Në mënyrë që t’i sigurojë përfitim maksimal popullsisë së Republikës së Shqipërisë, nga ndihma që do t’i jepet në bazë të kësaj marrëveshje dhe duke përjashtuar për sa mund të bihet dakord nga dy qeveritë: d) Organizatat individuale, publike ose private dhe punonjësit e organizatave publike ose private, që kanë lidhur kontratë ose financohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat ndodhen në Shqipëri për të vënë në zbatim sa flitet në këtë marrëveshje, do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësiave civile që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve”*.

Në germën “f”, të nenit 3, të Marrëveshjes Dypalëshe, përcaktohet gjithashtu se: *“f) Asnjë në këtë marrëveshje nuk ka për qëllim të prekë privilegjet dhe imunitetet e dhëna nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike”*.

Kjo marrëveshje është pranuar nga shteti Shqiptar me anë të Dekretit Presidential me nr. 224, datë 11.06.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Për rastin konkret rezulton se subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, AADF është një organizatë jofitimprurëse e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e themeluar në Shtetin Delaware më 9 Shtator 2009, e cila vepron në Shqipëri nëpërmjet degës së saj, Albanian- American Development Foundation – Dega Shqipëri dhe financohet me fonde të Qeverisë së Sh.B.A. AADF, vepron mbi programet e krijuara nga Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve, duke mbështetur zhvillimin e sektorit privat përmes edukimit, sipërmarrjes, zhvillimit të lidërshiptit, turizmit kulturor dhe ekoturizmit në Shqipëri.

Në një rast të ngjashëm, për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njëhësues se, *kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie, përveç rasteve kur është pranuar juridiksioni i gjykatave shqiptare vullnetarisht.*⁸

⁸ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011.

Me vendimin nr.00-2021-998, datë 28.06.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligj vendimarrjen e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi Fondi Shqiptaro- Amerikan i Ndërmarrjeve dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, gëzojnë atributet dhe përfitimet në lidhje me përjashtimin nga taksat në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 3 të Marrëveshjes Ekonomike Dypalëshe, midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës më datë 11.06.1992, në përputhje me nenin 3, shkronja “d”. Kolegji vlerëson se në kushtet kur palët me vullnet të lirë kanë shmangur legjislacionin shqiptar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre, atëherë vendimi i gjykatës për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor duhet të lihet në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, AADF, është subjekt përfitues i Marrëveshjes Ekonomike Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 10.06.1992 dhe, bazuar në këtë Marrëveshje Dypalëshe, AADF ka imunitet ndaj përgjegjësisë civile në Republikën e Shqipërisë, dhe është e përjashtuar nga juridiksioni shqiptar.

Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë se pavarësisht mungesës së juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe, çështja mund të hyjë në juridiksionin e gjykatave shqiptare në rast se pala heq dorë nga imuniteti.

Në çështjen objekt shqyrtimi, nuk rezulton që AADF, e cila gëzon imunitet në bazë të Marrëveshjes Dypalëve të datës 11.06.1992, të jetë në kushtet e heqjes dorë nga ky imunitet.

Gjykatat janë institucionet pranë të cilave mund të kundërshtohen aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, ndër të cilat edhe vendimarrja e Komisionerit. Po ashtu, neni 31/1 i Konventës së Vjenës “*Mbi Marrëdhëniet Diplomatike*”, ka përcaktuar qartë gëzimin e imunitetit të agjentit diplomatik edhe përsa i takon juridiksionit administrativ. Gjithashtu referuar praktikës gjyqësore, gjykata, ka pranuar mungesën e juridiksionit gjyqësor lidhur me shqyrtimin e çështjeve me palë AADF në territorin e Shqipërisë.

Përfundimisht dhe bazuar në sa më sipër është parashtruar dhe arsyetuar, Komisioneri, konstaton mungesën e juridiksionit administrativ dhe kompetencës ndaj subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, AADF. Në këto kushte, ankesa objekt shqyrtimi nuk mund t’i nënshtrohet hetimit administrative nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë mungesën e juridiksionit administrativ dhe kompetencës për shqyrtimin e ankesës nr.262, datë 24.12.2024, të paraqitur nga pala ankuese A.K kundër subjektit, Dega në Shqipëri e Fondacionit “Albanian American Development Foundation”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku:	Çdo shkak tjetër
Fusha:	Arsim
Lloji i vendimit:	Mungesë juridiksioni administrativ